

# PËRPARIMI

Reviste kulturore

Инв. № 100-IV-  
Сигн. 62 / 56

NUMRI 1-2

Maj — Qershuer 1955

VIETI

## ANTARET E REDAKSIS:

Ismet Shaqiri, Hivzi Sulejmani, Vojislav Dançetoviqi, Elhami Nimani, Mehmet Hoxha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Lorenc Antoni, Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Rexha, Mark Krasniqi, Jusuf Shushka, Hasan Vokshi, Ismet Mula, Shevqet Veliu, Masar Myrtezai

## KËSHILLI REDAKTUES:

Mehdi Bardhi, Stathi Kostari, Ali Rexha, Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi, Jusuf Shushka

## DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

## PËRMBAJTJA

### FJALA E REDAKSIS

### RODOLUB ÇOLAKOVIQ:

Për shkollat tona dhe pedagogjin tonë  
RRETH PROBLEMEVE GJUHSORE

— Nji mbledhje e randsishme  
H. VOKSHI e S. KOLGEKI:

Zanorja është dhe përdorimi i saj  
BORIS ZIHERL:

Diçka për estetikën shkencore  
VOJISLLAV DANÇETOVIQ:

320 vjetori i botimit të Fjalorit të Frang Bardhit  
J. SHUSHKA E M. GJEVORI:

C'është ndjenja e inferioritetit dhe si formohet te fëmijt  
SELMAN RIZA:

Linguistika, filologjija dhe gramatika deskriptive

## MBI ME TODËN E STUDIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Në ketë studim mendoj të mirrem pak me problematikës e studimit shkencuer të gjuhës shqipe, si degë e trungut gjuhsuer indoeuropjan. Me fjalë tjera, në ketë artikull due me tregue, në vija themelore, metodat e të studjuemit të gjuhës shqipe, mbassi ajo, për shkak t'individualitetit të saj shum të dalluem, u shtron shkenctarëve edhe metoda specifike, në disa raste më ndryshe se sa për gjuhët tjera. Për shembull: metoda e linguistikës shqiptare ndryshon shum a pak prej metodës, që përdoret në praktikë, kur studohen, të thomi, gjuhët e fqijve të saj: të Sllavëve (Sërbëve e Maqedonasve) ose Grekëve.

Para se të tentoj me paraqitë këto parime, më duhet me u ndalë së pari në disa vrejtje të përparshme, të nevojshme për me mujtë me ndjekë më tutje parashtresën time.

E para. Kur thom se këtu do të flas për ketë metodikë, me këtë, përnjimend, nuk mendoj me thanë se ajo paraqet ndonji novitet në vjetët e fundit. Në të vërtetë, kjo metodikë është gatue gjatë disa dhetëvjetshave (marrë rrumbullak afér 50 vjet), dhe sod është në nji naltsi të dukshme. Mbas Gustav Meyer-it duelën dijetarë të përmendun si Pedersen-i e shum tjerë, kështu që kjo disciplinë shkencore ka herë është vû në baza të shëndosha. Por, këtu due — në nji formë aq të përshtatshme sa më lejon vetë tema (në të vërtetë mjaft e komplikuese) t'i tregoj publikut të gjanë në çka qëndron kjo metodë shkencore.

E dyta. Prap për shkak të publikut të gjanë, i cili nuk merret aktivisht me çashtje gjuhsore, por që interesohet për rezultatet themelore të shkencës — më duhet të theksoj ndryshimin ndërmjet gramatikës, nga nji anë, dhe filologjisë e linguistikës, nga ana tjetër. Në të vërtetë ky është moment që egziston në të gjitha vendet e botës; por është e nevojshme me theksue sidomos ndryshimin kur është fjalë për ata popuj, ku është gjuha e përgjithshme kombtare (letrare), krijesë e rë. E qe sepse. Mund të mirret si rregull


ose deri edhe si ligj se interes i për gramatikën âsht i zhvilluem sidomos mû n'ambiente t'atilla, ku zhvillimi kombtar ka fillue në të kaluemen e afërme. N'ambiente të tilla ndodh që të marrin pjesë në zgjidhjen e çashtjeve të ngutshme, praktike të gjuhës kombtare, jo vetëm njerëz të degës, por edhe shtresa të gjana të kulturueme. Nëse duhet me përmendë ndonji shembull, atëherë mund të kujtojmë luftën e Kemalit për gjuhën popullore në Turqi ose aktivitetin e sodshëm të Maqedonasve për të sajue gjuhën e tyne letrare. Kështu ka ngja edhe te Sërbët (dhe Kroatët) në kohë të Vuk Karaxhiq-it: n'atë kohë të gjithë intelektualët e popullit kanë marrë pjesë edhe në zhvillimin e studimit të gramatikës sérbe, si edhe në fushatat rrëth saj. Në nji situatë të ngajshme ndodhen tash Shqiptarët; besoj se s'âsht nevoja me përmendë shembuj.

Por ai interesim i publikut të kulturuem qëndron në çash-tje gramatikore. Ai nuk u përket bazave shkencore të fakteve (se kjo, në të vërtetë, nuk âsht e nevojshme për ketë qëllim). Ndërkaq filologjija dhe linguistika nuk kë-naqen me gramatikën: ato janë mâtë gjana e mâtë thella. Ato tregojnë se si duhet, po gjithashtu edhe pse duhet kështu. Po marr mû nji shembull prej lamisë së gjuhës shqipe. Asht i njoftun aktiviteti i gramatikanëve rrëth kësaj: a lypset me shkrue ose jo në disa raste t'ashtuquejtunën „e pazâne” në mbarim të fjalës. Por, linguistika shkencore e shiqon ketë çash-tje nga nji perspektivë tjetër: ajo mundohet së pari me tregue: prej kah vjen kjo që në të njajtën fjalë ë-ja herë duket e herë zhduket.\* Posaçrisht ketë çashtje e ka zgjidhë mjeshtrisht i ndyeri albanolog i Vjenës — Jokl-i. Ai ka tregue se trajtat pa -ë redukton në nominativin e vjetër indoeuropjan (-os) e trajtat me -ë n'akuzativin e vjetër indoeuropjan (-on). Së-këndejmi rrjedh ndryshimi. E mandej âsht mâtë punë për gramatikën. Kjo vlen gjithashtu për çdo çashtje të tillë. Këtu qëndron ndryshimi. E këtu do të flas vetëm për anën shkencore e teorike të problemit, tue ia lanë praktikës së gramatikanëve (të shkollave) të nxjerrim përfundime praktike. Linguistikës shkencore të çdo gjuhe, pra edhe të shqipes i mbetet vetëm të vërtetojë elementet teorike. Vetëm në këto baza teorike mund të brumosen përfundime të drejta praktike — por kjo nuk âsht mâtë çashtje shkencore në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale, veçse së pari problem i përgjithshëm kulturuer. Përnjimend, ka pasë edhe shkenctarë të mëdhej, të cilët janë marrë edhe me çashtje praktike (kështu Pedersen-i në fillim

\*) Nuk âsht fjala për të folunit e Shqiptarëve të Veriut, ku ë-ja sod nuk shqiptohet.

të qindvjetshit XX, me të vërtetë u muer kalimthi edhe me çashtje të drejtshkrimit të shqipes); por kjo âsht diçka tjetër.

Mâ në fund, e treta. Gjuha shqipe — sikurse âsht e ditun në saje të Hirt-it e të Bariq-it — âsht mbasardhse e drejt-përdrejtshme e gjuhës së vjetër trakishte. Si e tillë ajo âsht pjestare e grupit gjuhsuer indoeuropjan, dhe mû degë lindore e tij, dmth. shkon me këto gjuhë: *baltike* (lituanishtja, letonishtja dhe prusishtja e vjetër), *sllave* (sërbokroatishtja, sllovenishtja, maqedonishtja, bullgarishtja, rusishtja, belorusishtja, ukrainishtja, çekishtja, sllovakishtja, polonishtja, luzhikosërbishtja, polapishtja), *armenishten* (sidomos me këtë!) dhe *indoiranjane* (sanskritishtja, persishtja etj.). Të gjitha këto gjuhë, pra edhe shqipja (dmth. trakishtja), e kanë zanafillën prej veriut. Për kundrejt këtij grapi linduer qëndron grapi gjuh-suer indoeuropjan perëndimuer: *greqishtja*, *gjermanike* (gjer-manishtja, holandishtja, anglishtja, danishtja, suedishtja, norvegjishtja, gotishtja), *italike* (latinishtja — e prej saj italish-tja, rumanishtja, frangjishtja etj., mandej oskishtja e umbrish-tja), *keltike* (këtu hyn irlandishtja, galishtja e vjetër në Francë etj.). \*) Nëse duhet me dhanë skemën, atëherë kjo duket kështu:



Sikurse shifet, të gjitha këto gjuhë janë të njij origjine; por, megjithkëtë, metoda nuk âsht gjithmonë e njaminë në hollsina, edhepse sistemi themeluer âsht i njaminë (krahasimi i gjuhëve të ndryshme ndërmjet tyne).

\*) Disa gjuhë të vjetra i përkasin grupit indoeuropjan, por shkenca ende nuk i ka sqarue si lindore ose perëndimore (kështu âsht rasti me ilirishten).

Natyrisht, këtu âsht fjala për metodën e studimit të gjuhës shqipe. Këtë e përcaktojnë kryesisht tri momente. I pari âsht ky: se gjuha shiqpe âsht sod e izolueme relativisht (afërsisht si greqishtja — të thomi përkundrejt Sllavëve ose Romanëve, e që stadiumi i saj i vjetër (dmth. gjuha trakishte) fatkeqisht nuk âsht ruejtë. Momenti i dytë âsht se Shqiptarët, në të vërtetë, kanë mbajtë deri më sod individualitetin gjuhsuer të tyne (dmth. me termë mâ shkencore, „tipin trakas” të tyne), porse kanë marrë në gjuhën e tyne plot elemente të hueja prej anësh së ndryshme, në ketë radhë: së pari *greke*, mandej *latine*, mâ vonë (në të vërtetë paralelisht) *sllave* dhe *italjane* (dhe *prap greke*) dhe së fundi *turke* (e me anë të Turqve edhe orientale tjera). Momenti i trëtë âsht: progresiviteti i madh i jashtzakonshëm i vetë gjuhës shqipe, dmth. ndrrimet e vazhdueshme gjatë zhvillimit të saj (fare ndryshe në ketë pikëpamje janë gjuhët sllave, të cilat janë tepër konservative). Nëse gjuha shqipe duhet krahasue përkah progresiviteti me tjerat, me gjuhët mâ të largta europjane, atëherë âsht shum e ngjajshme në ketë pikëpamje p. sh. me gjuhën frangjishte (e të mos thomi italishten). Për shembull *DIRECTUS* latinisht në gjuhën italishtë âsht ruejtë gati pa u ndryshue: *diretto*, ndërsa po prej kësaj fjale latine gjejmë te Shqiptarët fjalën tepër të ndrrueme *drejt* (e mâ tutje edhe *dreq*), e kështu edhe te Francezët *droit* (shqiptohet *drua*). Ose, edhe mâ mirë, prej latinishtes *IUDICEM* gjejmë italishten *GIUDICE*, ndësa Francezët thonë *juge* (shqipt. *zhyzh*), kurse Shqiptarët *gjyq* (dmth. vetëm nji rrokje!) Të gjitha këto momente u kanë imponue linguistave procedurë speciale gjatë studimit të gjuhës shqipe.

Të flas edhe pak mâ qartë. Derisa, për shembull, për studimin e gjuhëve sllave (ose greqishtes, latinishtes etj.) origjina e disa fjalëve („etimologjija”) nuk âsht e ndonjij randsije vendimtare (p. sh. fjalës sërbishte *voda* i përgjigjet saktsisht e njajta fjalë në të gjitha gjuhët sllave), — ndërsa pa etimologjí nuk ka linguistikë shqiptare, sepse të thomi vetëm në mënyrë shkencore mund të vërtetohet se fjala shqipe *gjum(ë)* i përgjigjet fare saktsisht latinishtes *somnus*, sërbokroatishës *san* ose greqishtes *hypnos*. Njerëzve që s'janë linguista, madjë qofshin edhe mâ të kulturuem, kjo — nuk u âsht e qartë.

Qe sepse mâ të mirët albanologë kanë qenë, e duhet t’ishin, gjithmonë së pari etimologët, dmth. hulumtuesat e zanafillës së fjalëve shqipe, qofshin këto fjalë të vendit (dmth. trakishte) ose të hueja (dmth. greke, latine etj.). Etimologët e spikatun,

pra, janë edhe G. Meyer-i edhe Bariq-i edhe Jokl-i etj.  
Po tregoj tash se si, me anë të studimit t'origjinës së  
fjalëve, vërtetohen edhe proceset e zhvillimit të gjuhës shqipe.  
Të morrim prap fjalën tashmâ të përmendun gjum(ë). E

Të marrim prap fjalën tashmâ të përmendun *gjum(ë)*. E krahasueme me latinishten *somnus*, në sllavishet *san* (*sen*, son etj.) — shqip *gjum(ë)* tregon ndrrimin e s-ës së trashigueme në gjakut. Shkaku i ndrrimit është akcenti, sikurse tashmâ është vërtetue. Prej kësaj nxjerrim përfundimin se s-ja indoeuropjane në shqipe është ndrrue në *gj.* Natyrisht, vetëm një shembull nuk do t'ishte i mjaftë që të nxirret ky ligj; porse shembuj të tillë ka edhe më. Po ketë *gj* të shqipes ndaj s-ës së gjuhës së njësive tjetër e gjejmë në shqipet *gjashtë*, nëse e krahásojmë me latinishten *sex* ose me anglishten *six*, e cila është e një origjine. I njajti rast është edhe me *gjî* (*gjini*) e një origjine me latinishten *sinus* (e njajta domethanje). Mandej edhe *gjëko(n)j* = angl. *sing* („me këndue“). E tjera.

Nëse marrim tash fjalët e hueja në shqipet, atëherë do të kemi situatë tjeter. Fjala greqishte sarx ka dhanë atë shqipe shark, pra përmban sh-ën për s.

Edhe fjala latinishte SPIRITUS ka dhanë atë shqipe shpirt; pra, prap gjejmë sh-ën shqipe (e jo gj-ën) për s.

Në fjalët shqipe me origjinë sllave për s-ën qëndron sh-ja ose s-ja shqipe (por, jo gj): *koshërë* prej sllav. kosor, *gushë* ose *gusë* për sérbi. *gus-ka* etj.

Mâ në fund në fjalët e italishtes që kanë marrë Shqiptarët — për s-ën qëndron gjithmonë vetëm s-ja: p. sh. *sigurue* (prej *sicurare*, *sigurare*), etj.

Edhe s-ja e turqishtes në shqipe mbetet gjithmonë si s:  
sahat, sall, sahân, saraç, etj.

Prej gjith kësaj rrjedh përfundimi: s-ja e vjetër e indo-europjanishtes (dhe s-ja e trakishtes) âsht ndrrue në shqipet në gj. Ky ndrrim âsht bâ qysh në kohën parahistorike. Kur kanë fillue Shqiptarët me pranue në gjuhën e tyne fjalë greqishte (dmth. të greq. së vjetër) dhe latinishte, ligji s = gj nuk ka pasë vleftë mâ dhe atëherë u krijue ligji i rí s = sh. Mëqenëse ndrrimi s = sh përfshin fjalët e vjetra të greqishtes, mandej të latinishtes dhe vetëm pjessisht të gjuhëve sllaviste (krahaso *gushë*, por edhe *gusë*) kjo do të thotë se ligji s = sh ka pasë vleftë aproksimativisht prej fillimit t'epokës sonë e deri diku afërsisht në shekullin e X. Atëherë mën edhe ky ligj, sepse fjalët e reja të gjuhëve sllaviste, e poashtu edhe veneciane dhe turqishte (këto të fundit para shek. XIV nuk vijnë në konsideracion) — e mbajnë s-ën (nuk e ndrrojnë në sh, e aq më pak në gj)

Nëse gjejmë, pra, fjalën shqipe gjarpen përkundejt latini shqiptarës *serpens* ose italishtes *serpente*, atëherë mund të tho-

mi me siguri se *gjarpen* nuk ësht marrë as prej latinishtes as prej italishtes, sepse s-ja e latinishtes do të jepte *sh-ën* e shqipes (e jo *gj-ën*), kurse s-ja e italishtes do të mbetej e pandrruemë. Domethanë ësht çashtja për fjalën e vjetër shqipe të vendit. Ajo ësht e njij origjine me fjalën latinishte (edhe italishte, krah. edhe frangjishten *serpent*); por nuk ësht marrë prej këtyne gjuhëve, poashtu sikurse nuk ësht marrë motrë prej latinishtes *mater* as prej sllav. *mati* as prej germanishtes *Mutter*. Sikurse shifet, këto ligjshmeni shpesh mund të përcaktohen fare saktsisht.

Ky ësht vetëm nji shembull, por kësi shembujsh ka plot. Pamë se ligji *s = gj* ësht shum i vjetër. Përkundrazi, ka edhe ligje shum të reja. Kështu ësht rasti, të thomi, me ndrrimin e grupeve të bashkëtinglloreve *rd* në *rdh*. Fakti se ky proces ësht fare i ri, shifet se çka ndodh edhe në fjalët turqishte: *bardhak* prej turq. *bardak*. E tjera kështu.

Nëse ndrrimet janë fare të reja, atëherë ato mund të studohen tue i krahasue trajtat e tashme shqipe me trajta që gjinden te shkrimtarët e vjetër. Kështu, për shembull, vehtja e parë e kohës së tashme te shum folje sod në gegnishtet mbaron me -*j* (p. sh. *gjëkoj* etj.) Por kjo -*j* ësht sajue prej - *nj-ës*. (tosknisht edhe sod *gjëkonj* etj.) E kjo *nj-* te shkrimtarët e vjetër gegë endë egzistonte. Simbas kësaj, ndrrimi i gegnishtes (pjessisht edhe i tosknishtes) — *nj = j* nuk mund të jetë më i vjetër se 2-3 shekujsh.

As -ë-ja (në mes të fjalëve) nuk ësht zhdukë aq herët në dialektet e gegnishtes. Përkundrejt gegizmës së sodshme të Veriut *shllin* qëndron sërbokroat. (malazez.) *šulina*, e cila nuk ësht sajue prej të sodshmes *shllin*, por prej më së vjetrës *shëllin* (ë), për të cilën na dëshmon trajta sëbokroatishë, ku për ë-n e vjetër të gegnishtes gjejmë vokalin (-u-: *š-u-lina*).

E tjera të ngjajshme. Unë përmenda këtu raste që janë shum a pak të thjeshta e të lehta për analizë; por ka edhe asosh shum të ndërlikueme. Në këto çashtje albanologët më të mirë kanë shpenzue orë të tana në përpjekjet e studimit të tyne. E kur të rendoheshin në ketë mënyrë të gjitha ligjet e gjuhës shqipe të vërtetueme kështu, atëherë do të kishim *gramatikën historike* të gjuhës shqipe. Kjo punë e madhe endë nuk ësht bâ; por, sikurse shifet, punët përgatitore tashmë kanë shkue mjaft përpara. Gramatika historike do të mund të tregojë, me shum a pak precizion, se si ësht zhvillue gjuha shqipe gjatë shekujve të stuhishëm të historis së vet dhe çfarë procesesh kanë ngja në sistemin e saj.

Kuptohet se mungesa e teksteve të vjetra të shkrueme, i vështirson mjaft këto veprime shkencore; por sod shkenca ësht aq e zhvillueme, sa mund të plotsojë edhe këte zbrastsi.

Sikurse kemi pasë rastin të shofim mā sipër, analiza shkençore është në gjendje të vërtetojë, për shembull, kohën („kronologjin”) e kontaktit të popullit shqiptar (e të parëve të tyne Trakasave) me popujt tjerë të ndryshëm. Thumb-i, në saje të me todave të ngjajshme — në të cilat nuk mund të hyjmë këtu — ka argumentue se kontakti i Shqiptarëve (Trakasve) me Grekët antikë është diçka mā i vjetër se sa kontakti me Romakët. Diskur mendohej se nuk ka pasë kontakt të vjetër shqiptaro-helen; sod e dijmë se ka egzistue dhe madjë është mā i vjetër se kontakti shqiptaro-romak, ndonse nuk ka qenë aq i fortë. Do të përmendi (simbas Thumb-it) se fjalët shqipe si *moken* (tosknisht *mokërë*), *brotëkë* etj. — me origjinë prej greqishtes së vjetër (greq. *makhana*; *brotakhos*). Mbës ndikesës greke zhvillohet ndikesa e fortë latine. Më mbas kësaj, sikurse është fare e kuptueshme, vijnë marrëdhjanjet e para shqiptaro-sllave. Mā vonë depërton në Shqipnë, nga nji anë, ndikesa italjane, e nga ana tjetër, ajo turke, kuptohet, krahas me ndikesa të reja greke e sllave. Lingüistika është mjeti shkençuer për studimin e historisë së gjuhës shqipe, e prandej edhe e historisë së popullit shqiptar. E ndoshta n'asnji gjuhë europjane lingüistika nuk ka aq randsi sa për gjuhën shqipe. Për ketë arsy qysh kaherë gjuha shqipe ka nisë me tërheqë lingüistat europjanë. Lingüistat zgjodhën, disi, gjuhën shqipe si objekt të studimit të tyne, ndoshta më për arsy se në të problemet janë aq të ndërlikueme, e, pra edhe metoda e punës këtu duhet të jetë mā e përsosun. Shkurt, studimi i gjuhës shqipe, shi për arsy të problematikës së saj tepër të komplikueme, paraqet për secilin lingüist shkollën mā të mirë dhe do të thotë provë e vështirë e aftsive të tij.

Për ketë shkak — po shtoj edhe këtë - rrëth albanologjisë janë tubue, pothuejse simbas rregullit, specialistat mā të spikatun, sepse lingüistat që s'janë të përgatitun mjaft nuk kanë mujtë me ua hy detyrave kaq të komplikueme. Shembull të tillë paraqesin edhe gjuhët keltike — poashtu të komplikueme për studim — në të cilat, përpos tjerësh, ia ka dalë në krye edhe Pedersen-i, në të vërtetë i njoftun si albanolog i madh.

Kuptohet se ky artikull nuk ka pretendim me paraqitë sistematikisht tanë problematikën e të studjuemit të gjuhës shqipe; qëllimi im është vetëm kaq: së pari, të kallxoj se sa e ndërlikueme është kjo metodikë dhe, së dyti, se detyrat, prap-prap, nuk janë të pazgjidhshme. Por se është e domosdoshme me marrë parasysh gjithmonë të gjitha elementet që janë me randsi në ketë rasë. Këtu qëndron metoda specifike e lingüistikës shqiptare ndërkombtare.

Dr. Ivan POPOVIQ